



Nr. 827/ Prot.

2



**MARRËVESHJE E PËRGJITHSHME
PËR PARTNERITET DHE BASHKËPUNIM**

Ndërmjet

UNIVERSITETI I TIRANËS
Shqipëri

I përfaqësuar nga Rektori – Prof. Dr. Artan Hoxha

dhe

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”
Kosovë

I përfaqësuar nga Rektori – Prof. Dr. Armand Krasniqi

Preambulë

Në përputhje me dëshirën e ndërsjellë për të promovuar aktivitete ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universiteti “Haxhi Zeka” (këtu e tutje referuar si Partnerët), të dy institucionet bien dakord për deklaratën e mëposhtme mbi bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor.

Partnerët vendosin të ekzekutojnë një Marrëveshje për Partneritet dhe Bashkëpunim, qëllimi i së cilës është të zhvillojnë kërkime shkencore të ndërsjellta, shkëmbime të stafit akademik, studentëve dhe programeve arsimore, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave në lidhje me arsimimin e studentëve dhe stafit.

Bashkëpunimi dhe zhvillimi i aktiviteteve mund të shtrihet në çdo fushë dhe lëndë ku të dy universitetet identifikojnë interesa të përbashkëta. Bashkëpunimi në fusha specifike mund të përcaktohet me miratim të ndërsjellë dhe të përfshihet në marrëveshje specifike shtesë pas nënshkrimit nga autoritetet e përshtatshme të universiteteve.

Neni I – Objekti

Partnerët bien dakord për fushat e mëposhtme të përgjithshme të interesit dhe bashkëpunimit:

1. Shkëmbimi i studiuesve dhe shkencëtarëve për të kryer kërkime me interes të ndërsjellë.
2. Shkëmbimi i profesorëve për leksione dhe vizita afatshkurtra.
3. Ftesa për studiues për të marrë pjesë në konferenca, simpoziume dhe mësimdhënie.
4. Shkëmbimi i informacionit, materialeve akademike dhe publikimeve në fusha të interesit të ndërsjellë.
5. Lehtësimi i lëvizjes së studentëve, përmes shkëmbimeve dhe vizitave, ndërmjet dy universiteteve.
6. Krijimi i programeve të përbashkëta të diplomave.

Neni II – Burimet Financiare

Partnerët bien dakord që të gjitha marrëveshjet financiare të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për Partneritet dhe Bashkëpunim ose çdo marrëveshje tjetër të mëpasshme duhet të negociohen sipas rregulloreve të secilit universitet dhe të varen nga disponueshmëria e fondeve. Partnerët pranojnë që kjo Marrëveshje për Partneritet dhe Bashkëpunim krijon një bazë mirëkuptimi dhe interesi të ndërsjellë dhe nuk përfshin ndonjë detyrim financiar për secilin universitet.

Neni III – Zbatimi

Nëse të dy Partnerët zgjedhin të hyjnë në një bashkëpunim kërkimor, palët do të diskutojnë me vullnet të mirë kushtet dhe termat e një marrëveshjeje të tillë dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje të pranueshme reciproke për të rregulluar bashkëpunimin kërkimor, duke përfshirë kushtet e financimit, përmbajtjen dhe pronësinë intelektuale të krijuar gjatë kërimit.

Ky dokument nuk ka për qëllim të krijojë detyrime ligjore ose të detyrueshme për ndonjë palë. Ai shpall qëllimet aktuale të Partnerëve për të përmirësuar marrëdhënien e të dy institucioneve për të ardhmen.

Para se të zbatohen ndonjë nga aktivitetet e përcaktuara në këtë Marrëveshje për Partneritet dhe Bashkëpunim, Partnerët duhet të hyjnë në marrëveshje me njëri-tjetrin, që do të përshkruajnë formën dhe përmbajtjen specifike të aktiviteteve dhe do të trajtojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e secilit Partner për ato aktivitete. Partnerët bien dakord të negociojnë termat e çdo marrëveshjeje të tillë në mënyrë të mirë dhe për qëllimin e përmirësimit të marrëdhënieve të Institucioneve.

Neni IV – Mbikëqyrja

Palët do të emërojnë Zyrat e Marrëdhënieve me Jashtë si përgjegjëse për koordinimin e këtij Memorandumi në institucionet e tyre. Rezultatet e arritura nga aktivitetet e zhvilluara në secilin program do t'i paraqiten periodikisht Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë të secilit institucion.

Komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet përmes kontakteve zyrtare të postës elektronike të Zyrave të Marrëdhënieve me Jashtë përkatëse.

Neni V – Konfidencialiteti

Palët bien dakord që çdo informacion që do të shkëmbehet sipas objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje do të përputhet me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale.

Neni VI – Kohëzgjatja dhe Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dy Partnerët dhe do të vazhdojë për një periudhë prej pesë (5) vitesh. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet dy palëve. Secili Partner ka të drejtë të përfundojë Marrëveshjen pa përgjegjësi duke dhënë gjashtë muaj njoftim me shkrim për këtë qëllim.

Ndryshimet dhe amendamentet në këtë Marrëveshje mund të bëhen vetëm me shkrim në formën e shtesave të numëruara të miratuara nga të dy institucionet.

Neni VII – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i termave të kësaj Marrëveshjeje ndërmjet dy palëve do të zgjidhet me negociata dhe mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet palëve. Kur palët nuk arrijnë një zgjidhje të pranueshme për çështjet dhe marrëveshja shkelet nga njëra palë, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje legjislationit në fuqi të Shtetit përkatës.

Kjo Marrëveshje bëhet në dy kopje në gjuhën shqipe, secila me vlefshmëri të njëjtë. Secila palë do të marrë nga një kopje.

Datë:

Datë:

UNIVERSITETI I TIRANËS
Sheshi “Nënë Tereza”
Rektorati UT, Tiranë
Shqipëri

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”
Rruga Eliot Engel
3000, Pejë
Kosovë



Prof. Dr. Artan Hoxha
Rektor

Prof. Dr. Armand Krasniqi
Rektor



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>534</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>4</u>	
Data / Datum / Date: <u>14.03.2025</u> Pejë / Peë		